

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për krime të rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtaret Mejreme Memaj kryetare, Have Haliti dhe Fllanza Kadiu, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.D. nga Peja, për shkak të veprës penale vrasje në tentative nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, duke vendosur, sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, av.G.B., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë P.nr.110/08 të datës 30.01.2017, në seancën e kolegjit, me datë 13.04.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuara, ankesa e mbrojtësit të akuzuarit K.D., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Pejë P.nr.110/08 i datës 30.01.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin Gjykatës Themelore-DKR në Pejë P.nr.110/08 të datës 30.01.2017, i akuzuari K.D., është shpall fajtor për veprën penale vrasje në tentative nga 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.01.2017 e deri me datën 30.01.2017.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 100 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 25 €, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërie se aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit av. G.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me kusht, apo dënimi i shqiptuar t'i zëvendësohet me dënim me gjobë.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën PPA/I.nr.153/17 të datës 17.03.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezantuan, mbrojtësi i të akuzuarit av.G.B., ndërsa në seancë nuk ka prezantuan Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe i dëmtuari A.B., të cilët janë njoftuar me rregull për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit dhe pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, është e pa pabazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë, pretendon se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqenëse nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur ta argumentojë gjendjen faktike dhe të arsyetojë vendimin mbi dënimin.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar ankesën e paraqitur nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, por edhe dhe sipas detyrës zyrtare, konstaton se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet e mjaftueshme lidhur me veprimet inkriminuese të akuzuarit K. Dreshaj dhe ka nxjerr konkludim të drejtë se e ka kryer veprën vrasjes në tentative nga neni 146 lidhur 20 të KPK-së, ashtu që nga arsyetimi i aktgjykimit ankimuar del se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për veprimet inkriminuese dhe përgjegjësin penale juridike të akuzuarit. Kjo Gjykata gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pa cekur se cilat shkelje janë bërë në rastin konkret, janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, nuk ka vërtetuar dashjen e të akuzuarit për të kryer veprën penale me të cilën është akuzuar, ku gjykata në arsyetim të aktgjykimit cekë se qëllimi i të akuzuarit nuk ka qenë që të dëmtuarin ta privojë nga jeta, por mjeti me të cilin e ka përdorur mundet me qenë vdekjeprurës, ky arsyetim i gjykatës nuk mund të qëndrojë, sepse gjykata ka për obligim ta vërtetojë edhe dashjen e kryesit, ku në rastin konkret ekziston edhe ekspertiza e ekspertit mjeko ligjor, i cili ka konstatuar se të dëmtuarit i janë shkaktuar lëndime të lehta trupore, ashtu që gjykata duke pasur parasysh këto fakte është dashur ta rikualifikoje veprën penale për të cilën e ka shpallur fajtor, në vepër penale lëndim i lehtë trupor, të cilin fakt e ka pranuar edhe vetë i akuzuari, pasi që nuk është vërtetuar dashja e të akuzuarit dhe qëllimi i tij që ta privojë nga jeta të dëmtuarin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk qëndrojnë, se nga shkresat e lëndës, procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, si dhe nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet se i akuzuari me datën 24.10.2007 rreth orës 23,30 min, në lagjen “Kapeshnica” afër Xhamisë së madhe në Pejë, me dashje ka tentuar të privoj nga jeta të dëmtuarin A.B., në atë mënyrë që natën kritike për shkak të një konflikti që kishte pasur tri netë para natës kritike I.H. me të miturin A.D., i akuzuari K. me thikë e ka sulmuar të dëmtuarin Ar., ku e ka goditur në duar dhe një herë në qafë në anën e majtë nën nofull e poshtme, duke i shkaktuar lëndime trupore të cilat në momentin e shkaktimit kanë qenë të rrezikshme për jetë, ashtu që nga arsyetimi i aktgjykimit ankimuar del se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për veprimet inkriminuese dhe përgjegjësin penale juridike të akuzuarit. Kjo gjendje faktike, është vërtetuar nga deklaratat e të dëmtuarit A.B., dëshmitarëve K.B. dhe I.H., raporti i vendit të ngjarjes, foto-dokumentacioni, raportit të eksperit mjeko ligjor Dr. A.G. dhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit, i cili ka pranuar se e ka lënduar me thikë të dëmtuarin.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit, se dashja e të akuzuarit nuk ka qenë për ta privuar nga jeta të dëmtuarin, janë të pabazuara, se me vetë faktin se i akuzuari me thikë e ka goditur të

dëmtuarin në qafë, ka qenë i vetëdijshëm se mund të shkaktohet pasoja si në rastin konkret, kurse mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë ngatërron bazat ankimore, duke thënë se gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa nga përmbajtja e pretendimeve ankimore të mbrojtjes rezulton se aktgjykimi atakohet për shkak të shkeljes së Ligjit Penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë pretendon, se është shkelur Ligji Penal në dëm të akuzuarit, kur gjykata ka gjetur se me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë, sepse në veprime e të akuzuarit nuk ka pasur dashje, në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale lëndim i lehtë trupor.

Sipas kësaj Gjykate, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur Ligji Penal në dëm të akuzuarit, se në rastin kemi të bëjmë me vepër penale lëndim i lehtë trupor, nuk qëndrojnë, se të i akuzuari ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale që i vihet në barrë, ashtu që gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikua Ligjin Penal, kur të akuzuarin e ka shpall fajtor për veprën penale vrasje në tentativë nga 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, si dhe nuk ka gjetur rrethana që përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit pretendon, se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është dënim i ashpër, me të cilin nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, meqenëse kanë kaluar 10 vjet nga kryerja e veprës penale, i akuzuari në kohën e kryerjes se veprës penale ka qenë në moshën 19 vjeçare, me të dëmtuarin është pajtuar, tani ka krijuar familje dhe ka fëmijë dhe shkuarja e tij në vuajtjen e dënimit pas 10 vitesh, nuk mund të ketë efekt, por përkundrazi mund të shkaktojë pasoja në jetën dhe familjen e tij, andaj ka propozuar se me dënim me kusht, apo zëvendësimi i dënimit të shqiptuar në dënim me gjobë, mund të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me ligj për këtë vepër penale.

Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, është i pa bazuar.

Duke e vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat, siç parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, në ankesat e ushtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit nuk theksohet edhe ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, të cilat kishin me ndikuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim, më i butë siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë. Rrethanat lehtësuese që i ka marr parasysht gjykata e shkallës së parë për të akuzuarin me rastin e caktimit të dënimit, se më parë nuk ka qenë i dënuar, është penduar për veprën e kryer penale, sjellje korrekte të akuzuarit gjatë gjykimit, kurse si rrethana posaçërisht lehtësuese ka marrë parash moshën e re të akuzuari në kohën e kryerjes se veprës penal, se i akuzuari ka shpreh pendim të thellë dhe në një formë i ka pranuar veprimet e kryera, i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse rrethana renduese nuk ka gjetur. Për këto arsye Gjykata e Apelit vlerëson se dënimi që i është shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, prandaj duke i pas parasysht rrethanat që u theksuan më lartë, kjo gjykatë gjen se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.146/17 të dt.13.04.2016

Procesmbajtësja,
Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit,
2.Have Haliti

3.Fllanza Kadiu

Kryetari i kolegjit
1. Mejreme Memaj